



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 2573/24 Datë: 18/12.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes 132 të mbajtur më 09 dhe 10.12.2024, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet në nivel institucional Kolegji UBT kampusi kryesor në Prishtinë, për periudhën pesë (5) vjeçare (1 tetor 2025 deri me 30 shtator 2030).
- II. Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor në Prishtinë që deri me 30 shtator, të dorëzojnë në AKA planin për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ekipi i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji UBT kampusi kryesor në Prishtinë (Tutje UBT) ka parashtruar kërkesë me Nr.prot.1496/24, datë 31.07.2024, pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA) për riakreditim në nivel institucional.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegji UBT me qëllim të vlerësimit në nivel institucional. Vizita është organizuar me datë 20.11.2024, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Melita Kovacevic, Mauro Zarelli dhe Marija Vasilevska.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr. 03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit) ekipi i vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtar) ka hartuar raportin përfundimtar të vlerësimit dhe për fushat e standardeve të akreditimit nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Kolegji UBT është vlerësuar se përmbushë:

- Plotësisht tetë (8) standarde;
- Substancialisht dy (2) standarde dhe
- Pjesërisht një (1) standard të akreditimit.

Duke ju referuar standardeve të plotësuara Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtar) ka rekomanduar që Kolegji UBT të riakreditohet për periudhën pesë (5) vjeçare, nga 1 tetor 2025 deri me 30 shtator 2030.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 132-të, të mbajtur më 09 dhe 10.12.2024 ka shqyrtuar kërkesën e Kolegji UBT dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar.*



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi ju dërgohet :

- Kolegji UBT
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.